



NJOFTIM - THIRRJE PËR APLIKIM

Përkrahje me bursa shkollore për vitin shkollor 2015/2016

Njoftohen të gjithë nxënësit e klasave të nënta se me mbështetje të Qeverisë së Dukatës së Madhe të Luksemburgut, organizata Foundation Kosovo-Luxembourg do të bëjë ndarjen e bursave për nxënësit që do të fillojnë vitin shkollor, klasën e 10-të, në Shtator 2015, pra për vitin shkollor 2015/2016.

KUSH MUND TË APLIKOJË:

Nxënësit e klasave të 9-ta, të cilët janë banorë të komunave: Hani i Elezit, Kaçanik, Viti dhe Killokot dhe të cilët do të fillojnë klasën e 10-të në Shtator 2015.

KRITERET E PËRZGJEDHJES DHE PRIORITETET:

- Nxënësit të cilët vijnë nga familjet me asistencë sociale;
- Nxënësit të cilët janë pa prindër apo vetëm me njërin prind;
- Nxënësit të cilët familja e tyre ka më shumë se tre fëmijë të cilët shkojnë në shkollë;
- Nxënësit, prindërit e të cilëve janë të papunësuar;
- Nxënësit e fshatrave të cilët udhëtojnë nga një distancë e largët deri në shkollë;
- Nxënësit me sukses të shkëlqyer;
- Nxënësit të komuniteteve që jetojnë në Kosovë;
- Femrat.

FORMAT PËR APLIKIM MUND TË MERREN:

- **Kërkoni** formën e aplikacionit duke dërguar email në: info@fkl-ks.org, **shkarkoni** atë nëpërmjet ueb faqes së komunës tuaj ose **merrni** atë gjatë sesioneve informuese;

AFATI I FUNDIT PËR APLIKIM dhe DORËZIMI I APLIKACIONEVE:

- Data e fundit për aplikim është me **26 Qershor 2015**, e Premte, ora **16:00**.
- **Aplikacionet e plotësuar dhe dokumentet mbështetëse duhet të dorëzohen me postë në adresën:**

Foundation Kosovo-Luxembourg
Fahu Postar nr. 9
70000 Ferizaj, Kosovë

ose nëpërmjet emailit në info@fkl-ks.org

Ky projekt financohet dhe mbështetet nga Qeveria e Dukatës së Madhe të Luksemburgut ndërsa zbatohet nga Foundation Kosovo-Luxembourg.